

MES LIRISË SË SHPREHJES DHE “GJUHËS SË URREJTJES”

Fjala e mbajtur nga Irma Baraku, Komisionere Për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Festivalin e Diversitetit, më 17 Maj 2012.

Të nderuar zotërinj Ambasadorë,

Të nderuara zonja Deputete,

E nderuar znj.Kodra,

I nderuar Z. Totozani,

Të nderuar organizatorë dhe pjesmarrës,

Duke ndjekur debatin e kohëve të fundit mbi të drejtat e komunitetit LGBT, mendova të reflektoj disa ide mbi lirinë e shprehjes dhe kufijve deri ku mund ta ushtrojmë atë. Shoqëria demokratike është e lidhur ngushtë me respektimin e të drejtave themelore të njeriut, aq sa është kristalizuar idea se “*Demokracia dhe liria e shprehjes kanë bashkëjetuar gjatë dhe nuk mund të ekzistojnë të ndara*”. Për më tepër, pavarësisht se në ç’ formë realizohet liria e shprehjes, ajo nuk mund të trajtohet ndryshe veç si e drejtë themelore e njeriut. Në këtë këndvështrim dëshiroj të theksoj dy aspekte të saj:

Së pari, trajtimin e lirisë së shprehjes si mjet i realizimit shpirtëror dhe intelektual të individit, *lirisë personale* dhe të drejtës së individit për të realizuar personalitetin e vet. Në këtë aspekt një individ, pjesëtar i komunitetit LGBT gëzon çdo të drejtë themelore që Kushtetuta i njeh çdo individ: si liria e mendimit, e shprehjes, e organizimit dhe tubimit. Më tej kësaj, me një ligj të veçantë “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është garantuar mbrojtja e të drejtave themelore të çdo individit nga sjelljet diskriminuese edhe për shkak të orientimit seksual.

Debatet dhe diskutimet mbi tema ndaj të cilave si shoqëri kemi preferuar t’i anashkalojmë janë të nevojshme pavarësisht argumentave pro dhe kundër që gjenerojnë. Por, në këto debate është e domosdoshme të bëjmë të qartë dallimin mes opinioneve dhe informacionit faktik. Nëse nuk e realizojmë një ndarje të tillë rrezikojmë të krijojmë paragjykime dhe stereotipe negative mbi pjesëtarët e këtij komuniteti. Duke mos pasur aftësinë profesionale të mjekut për të konkluduar mbi statusin mjekësor të orientimit seksual, e ndjej për detyrë t’i referohem atyre organizimave që mund ta bëjnë një gjë të tillë. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) që prej vitit 1990 e ka hequr homoseksualitetin nga Klasifikimi Ndërkombëtar i Statistikave të Sëmundjeve dhe Problemeve lidhur me Shëndetin. Duke qenë juriste në profesion, më duhet të theksoj se homoseksualizmi është dekriminalizuar në vitin 2001, me ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal, sipas ligjit nr. 8733, datë 24.01.2001.

Së dyti, trajtimin e lirisë së shprehjes si mekanizmi kryesor, që mundëson rolin politik të individit dhe të grupimeve të ndryshme në jetën politike.

Në këtë aspekt, vlerësoj maksimalisht rolin që liria e fjalës ka për konsolidimin e pozicionit politik të individit dhe grupit që ai përfaqëson. Është krejt e ligjshme që individët e përfshirë në politikë të përdorin lirinë e shprehjes, në mënyrë që nëpërmjet diskursit politik të arrijnë

tek elektorati mbështetjen e të cilit synojnë. Pikërisht për këtë arsye shpesh opinioni i një force politike shkon si një informacion faktik drejt publikut të cilit i drejtohet diskursi.

Deri këtu shumë njerëz mund të konvergojnë e të mos ndjehen në kundërshti me njëri-tjetrin. Por tek dëgjon shprehje të tilla si “i jap plumb ballit” apo “meritojnë vetëm hurin” lind një pyetje të cilës nuk mund t’i shmangemi dot: A është liria e shprehjes një e drejtë absolute? Përgjigjja është e thjeshtë dhe qëndrimi ligjor është i sanksionuar përmes normash, duke filluar me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 17 të saj përcakton se jo. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut mbajnë të njëjtin qëndrim. Ka një kufi të cilin nuk mund ta kalojmë kur ushtrojmë lirinë e shprehjes.

Gjuha e përdorur kohët e fundit, e quajtur “gjuha e urrejtjes” kërkon një trajtim juridik, por edhe një qëndrim negativ të vendosur. Nuk ka qenë e thjeshtë as për institucionet ndërkombëtare një reagim i menjëhershëm në raport me atë që quhet “gjuhë e urrejtjes” apo “hate speech”. Ndonëse nuk ka dhënë një përkufizim për këtë koncept, Gjykata e Strasburgut ka mbajtur qëndrim ndaj përdorimit të kësaj gjuhe, duke kërkuar ndërhyrjen e organeve përkatëse ndaj përdorimit të papërgjegjshëm të lirisë së shprehjes. Duke mbajtur një qëndrim të tillë kryesisht për gjuhën që nxit urrejtjen racore, ajo e ka shtrirë së fundmi këtë edhe në raport me nxitjen e urrejtjes ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual, duke krijuar kështu një praktikë gjyqësore ku mund të mbështetemi për trajtimin juridiksht të debateve të tilla.

Ky ishte një konsolidim i qëndrimeve që institucionet europiane, ku aderon edhe Shqipëria, kishin ndërmarrë më parë. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, përmes Rekomandimit CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave “*Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor*”, miratuar në datë 31 mars 2010, kërkon nga shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të të drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre. Në kuadër të garantimit të kësaj të drejte, rekomandohet që: “Shtetet anëtare duhet të marrin masat e duhura për të luftuar të gjitha format e shprehjes, duke përfshirë, në media dhe në internet, të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se ka gjasa për të prodhuar efektin e nxitjes, përhapjen ose nxitjen e urrejtjes apo të tjera forma të diskriminimit kundër personave gay lesbike, biseksuale dhe transeksuale. *Një “gjuhë urrejtje” e tillë, duhet të ndalohet dhe publikisht të kundërshtohet kurdo që ndodh.*”.

Liria e shprehjes është themelore për një shoqëri demokratike, por ajo s’ mund dhe nuk duhet të çenojë jetën, sigurinë dhe dinjitetin e askujt.